



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 147, datë 24.06.2021

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “INFO-TELECOM” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13, të Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Proçedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.06.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 95/2 prot., datë 22.06.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi “Licencimin e shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 136, datë 07.06.2021, ka miratuar fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 6/15 prot., datë 08.06.2021, ka bërë publikimin në median e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “INFO-Telecom” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe në përfundim të afatit të njoftimit (datë 21.06.2021), nuk rezultuan vërejtje apo ankesa nga palët e interesuara.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 713/1 prot., datë 09.06.2020, ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Referuar deklaratës së shoqërisë rezulton se ajo kryen dhe veprimtari të tjera, e konstatuar edhe në përmbajtjen e Ekstraktit të QKB-së, shoqëria do të orientohet të mbajë llogari të ndarë për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të Aneksit A, të Rregullores për

Procedurat dhe Afatet për dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë rezulton se plotëson tërësisht kërkesat e Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin dhe Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike, si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar**
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “INFO-Telecom” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI